

ZOTIMET DHE PROGRAMET E REJA QEVERIA KURTI 3

2025-2029

V

PRODHIMTARIA
NDËRMARRËSIA

FINANCAT
PUBLIKE

INOVACIONI &
TEKNOLOGJIA

TRANSPORTI
PUBLIK

BREZOVICA

MËRGATA

FAMILJA

GRATË

PUNËTORËT

STUDENTËT

SHKOLLIMI

SHËNDETI

BUJQËSIA

UJËRAT

ENERGJIA
DHE MINIERAT

INFRASTRUKTURA

INVESTIMET
KAPITALE

KOMUNAT

SPORTI

ARTI

TRASHËGIMIA
KULTURORE

DREJTËSIA

SIGURIA

MBROJTJA

POLITIKA E
JASHTME DHE
INTEGRIMET
EVROPIANE

cep më cep



118

Të dashur qytetarë
të Republikës së Kosovës,

I kemi dëshirën dhe vullnetin,
guximin dhe besimin, idetë dhe planet.
Jemi shpresë e njëri-tjetrit. Andaj,
krejt bashkë, drejt Kosovës që e duam,
që na duhet, e që i duhem.

Ju falemnderit!



ALBIN KURTI

Të dashur qytetarë,

Pas referendumit të 14 shkurtit, qeverisjen e morëm në kohën kur e gjithë bota po përballej me pandeminë Covid-19, një pandemi e cila ndodh një herë në një shekull.

Pandeminë e menaxhuam duke siguruar vaksinat e duke vaksinuar shumicën e qytetarëve në afat rekord, gjë që mundësoi rihapjen e ekonomisë e rritjen e vrullshme të saj.

Por nuk kaluan as një vit, dhe në derë na trokiti kriza energetike dhe rritja e kostos së jetesës si pasojë e luftës në Ukrainë. E kriza të tillë kontinenti evropian nuk i kishte parë në 50 vitet e fundit. E sikur të mos mjaftonin gjithë këto sfida globale, gjatë këtyre katër viteve kishim edhe sfidat e pengesat e brendshme.

Por megjithëkëto ia dolëm, dhe po bëhem qeveria e parë që e çon mandatin deri në fund. Krizat e sfidat globale tashmë u tejkaluan dhe do t'i tejkalojmë edhe sfidat e brendshme. E për këtë na duhen 500 mijë zemra që rrahin me të njëjtin ritëm me datën 9 shkurt, cep më cep vendit, ashtu që mandati i ardhshëm të jetë edhe më i fuqishëm, e ne të punojmë edhe më shpejt.

Ekonominë e morëm me më pak sesa 7 miliardë euro vlerë, dhe po e përmbyllim mandatin me më shumë sesa 10 miliardë euro vlerë.

Dyfishuam eksportet e vendit e poashtu edhe investimet e huaja direkte. Investimet kapitale shënuan rekord të ri me 654 milionë euro të ekzekutuara në vitin 2024.

Ekonomia u rrit falë mirëmenaxhimit të buxhetit por edhe rritjes së punësimit. Nga 350 mijë të punësuar sa kishte ekonomia në fillim të mandatit tanë ka 430 mijë dhe shumica e këtyre të të punësuarve shtesë janë të rinjë dhe gra. Kjo u arrit si rezultat i shumë masave që fokus kryesor kishin punësimin e grave, të rinjve dhe komuniteteve joshumicë.

Ky zhvillim ekonomik, bashkë me suksesin e shënuar në formalizimin e aktivitetit ekonomik dhe rritjen e besimit të qytetarëve kundrejt qeverisë qendrore, rezultoi në rritje të paprecedentë të mundësive buxhetore. Qeveria jonë u përkujdes që kjo mundësi e shtuar buxhetore të shfrytëzohej në mënyrën më të mirë të mundshme.

E rritëm fuqishëm mbështetjen për ndërmarrje e fermerë. Shtuam buxhetin për shkolla, spitale, qendra të mjekësisë familjare e barëra. Arsimin e bëmë falas për të gjithë. Ndërtuam e rinovuam objekte sportive e të trashëgimisë kulturore cep më cep Kosovës. Investimet publike kapitale i ngritëm në nivele të pashënuara më pare. E po ashtu e rritëm financimin për më shumë rend, siguri e sovranitet. Rritëm pagat në sektorin publik tre herë brenda mandatit, e rritëm dy herë pagën minimale, rritëm pensionet e ndihmat sociale si dhe shtuam bursat për studentë.

Për herë të parë ofruam mbulesë universale të shtesave për mbi 400.000 fëmijë e rreth 70.000 gra lehona.

Premtuam edhe drejtësi e ligjshmëri. Luftuam me shumë sukses krimin e organizuar dhe korruptionin. U mbyllën dhjetëra laboratorë të drogës e prodhime ilegale të kriptovalutave. U mbyllën dhejtëra rrugë ilegale e u vendos rendi në çdo cep të territorit të vendit tonë. E ndërprenë më sukses keqpërdorimin e skajshëm nëpër ndërmarrjet publike dhe nga ndërmarrje që operonin me humbje të vazhdueshme e mbipunëism partiak e politik, shumicën e tyre i ndihmuam të shënojnë rezultate positive financiare. Implementuam reformë të thellë të sistemit të drejtësisë. E bëmë Kosovën ndër tri shtetet me progresin më të shpejtë në botë në reformat në drejtësi.

Falë përmirësimit të imazhit të shtetit në botë dhe angazhimit tonë me shtetet skeptike brenda zonës Schengen, siguruam lirinë e lëvizjes pa viza për qytetarët tanë duke filluar nga 1 janari i vitit 2024, duke mundësuar qindra mijëra familjeve të vizitojnë lirshëm mërgatën tonë, e dhjetëra mijëra të rinjve të vizitojnë vendet e tyre të preferuara anekënd Evropës. Siguruam që Kosova të organizojë lojërat mesdhetare Prishtina 2030, duke u bërë vendi i parë në region që i mundësohet organizimi i kësaj ngjarje kaq të madhe sportive.

Pothuaj në secilën fushë të angazhimit shënuam rekorde të suksesit. Tani në mandatin e ri të qeverisjes synojmë të thyejmë secilin rekord të vendosur nga vetë ne.

Qeveria e re

Do të vazhdojmë të gjitha punët e mira që kemi filluar e do të nisim plot ide e projekte të reja.

Do të përshpejtojmë rritjen ekonomike me mbështetje të ndërmarrjeve prodhuese dhe inovacionit.

Do të rrisim pagat, pensionet, e mbështetjen sociale krahas rritjes së përshpejtuar të ekonomisë.

Do të shënojmë rekorde të reja në investime kapitale me projekte strategjike që rrisin aktivitetin ekonomik.

Do të sigurojmë edhe shumë vende të reja të punës si përvajzat e djemtë ashtu edhe gratë përtë arritur shifrën prej mbi gjysmë milionë të punësuar deri në fund të mandatit.

Do të kujdesemi përmë shumë siguri, drejtësi e barazi, dhe përmë pak krim, korruption e varfëri. Do të vazhdojmë punën për arsim e shëndetësi më cilësore.

Do të punojmë e angazhohemi përmë shumë prodhim e eksport, mbështetje të ekonomisë qarkore nga prodhimi deri tek ripërpunimi i mbetjeve, më shumë siguri energetike e më pak ndotje të ambientit.

E do të përkushtohemi përmë shumë kualitet të jetës e rritje të mëtejme të jetëgjatësisë.

Do të bashkëpunojmë me mërgatën tonë për progresin e vendit.

Do të mbështesim pa rezervë projekte zhvillimore për shqiptarët e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit e Sanxhakut.


Do të vazhdojmë kordinimin me Republikën e Shqipërisë duke thelluar projektet e përbashkëta nga energjia, arsimi e mbrojtja tek politika e jashtme.

Andaj po paraqesim 25 zotimet tona së bashku me programet e reja që kemi planifikuar përmadatin e ri që së bashku me ju të dashur qytetarë do t'i kthejmë në një aksion dinamik të gjithanshëm përtë ta thelluar progresin, solidaritetin, drejtësinë e forcimin e shtetit tonë.

Kryeministri Albin Kurti
Janar, 2025

ZOTIMET DHE PROGRAMET E REJA QEVERIA KURTI 3 2025-2029





PRODHIMTARIA NDËRMARRËSIA

Banka Zhvillimore

Me Bankën Zhvillimore do të mbështetet financimi i drejtpërdrejtë i projekteve strategjike dhe prioritare, kurse përmes nënhuazimit nëpërmjet sektorit bankar do të mbështeten ndërmarrjet e vogla dhe të mesme apo dhe individët, për investime në fushat prioritare me kushtet e favorshme të Bankës Zhvillimore.

Ndërsa nëpërmjet letërgarancive për pagesa do të ndihmojmë prodhuesit dhe eksportuesit për të pasur qasje më të lehtë në financa e likuiditet.

Programi "1 miliard euro në prodhim"


Për të krijuar një ekonomi të qëndrueshme dhe me vende pune që paguajnë mirë, do të krijojmë programin për mbështetjen e investimeve në kapacitete prodhuese në vlerë 1 miliard euro, përmes garantimit të kredive për investitorët.

Secili investitor do të ketë mundësinë të përfitojë nga garancia që shteti do të ofrojë për kreditinë e nevojshme për investim.

Kjo u mundëson investitorëve qasje shumë më të lehtë në financa e kosto shumë më të lirë të financimit. Përveç kësaj, investitorët do të kenë mundësinë të përfitojnë edhe nga skemat e subvencionimit të pagave.

Amortizimi i përshpejtuar për investimet e reja

Të gjitha bizneseve që investojnë, përmes amortizimit të përshpejtuar do t'u mundësojmë përqendrimin e vlerës së amortizuar të investimeve në vitet e para ashtu që në këto vite të zgogëlohen detyrimet tatimore. Kjo masë do ta zgjidh problemin e likuiditetit gjatë viteve të para të investimit të ri në bizneset tuaja.




FINANCAT PUBLIKE

Shtetit ia kemi kthyer terminalet doganore ashtu që të mos ketë më kosto zhvatëse për tregti të jashtme, dhe po i digitalizojmë arkat fiskale që të liberalizohet tregu, duke hequr këtë barrë të panevojshme për bizneset. Punën e mirë do ta vazhdojmë edhe gjatë mandatit të ardhshëm me ndërtimin e sistemit të ri digjital të faturës elektronike biznes-biznes, sistem i cili do të mundësojë monitorim në kohë reale të detyrimeve të TVSH-së, por të njejtën kohë mundëson edhe rimbursimin automatik e pa procedura të stërvjatuarë të TVSH-së për bizneset në kreditim.

Për të mbështetur likuiditetin e bizneseve, mbledhjen e TVSH-së për mallrat që hyjnë në kufi do ta zhvendosim nga kufiri në brendi të vendit. Data e pagesës së detyrimit të TVSH-së do të zhvendoset në muajin pasues nga muaji kur lind detyrimi në kufi, ngjashëm siç e kanë bizneset për TVSH-në e brendshme.

Për veturat e importuara nga Evropa do të heqim taksën doganore prej 10%, duke thjeshtësuar edhe kriteret për dëshminë e origjinës, gjë që do të mundësojë kosto më të lirë për qytetarët për blerjen e veturave.



INOVACIONI & TEKNOLOGJIA

Valuta digjitale e Kosovës

Këtë mandat do ta nisim me Valutën digjitale të Kosovës.

Valuta digjitale, e bazuar në blockchain, e krijuar nga shteti do të përdoret për pagesa. Krijimi i valutës digjitale hap mundësitë të reja për inovacion dhe krijon ekosistem të inovatorëve. Me këtë e vendosim Kosovën në qendër të zhvillimeve më të fundit teknologjike.

Mbështetje industrisë së IT

Për kompanitë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që po tregohen të sukseshme në rritjen e punësimit do të ideojmë dhe ndërtojmë një ICT TOWER (Kulla TIK) si investim publik në qendër të Kryeqytetit si dhe do të ofrojmë mbështetje për hapësira e objekte në qytetet kryesore. Do të largojmë të gjitha kufizimet për njohjen e shpenzimeve të trajnimit si shpenzime të zbritshme.



TRANSPORTI PUBLIK


Programi i transportit "Anembanë"

Transporti publik në vendin tonë është një nga fushat ku kërkohet shumë angazhim e transformim.

Për këtë qëllim ne do të fillojmë me jetësimin e Programit "Anembanë".

Do të krijojmë, pra rrjet të integruar të transportit publik në tërë territorin e vendit. Fillimisht për trafikun urban, e në vijim edhe për trafikun ndër-urban. Integrimi do të jetë nëpërmjet biletës mujore të integruar. Secili shfrytëzues do të mund të udhëtojë anembanë Kosovës, pa pasur nevojë për biletë tjetër, dhe duke përdorur vetëm transportin urban dhe ndërurban.

Bileta do të jetë e subvencionuar dhe me kosto minimale për shfrytëzuesit. Synimi është që me një kosto të përbollueshme prej 10 euro në muaj, secili të ketë mundësi të shfrytëzojë programin "Anembanë".



BREZOVICA

Këtë mandat të ri e nisim me projektin e madh "Brezovica".

Ne do të investojmë deri në 500 milionë euro në infrastrukturë rrugore, akomodime moderne, pista të reja e rrjet bashkëkohor të teleferikut.

Do të sigurohem që Brezovica të bëhet e famshme jo vetëm në rajon por edhe në Evropë e botë.

Zhvillimi i këtij projekti do të jetësohet nëpërmjet dy komponentëve. Komponenti i parë është infrastruktura përcjellëse, ndërtimi dhe mirëmbajtja e saj. Ndërkaq, komponenti i dytë do të jetë pjesa e ndërtimit dhe operimit të hotelerisë, gastronomisë, shërbimeve rekreative, sportive dhe shërbimeve të tjera.




MËRGATA

Krahas nismave që ndërmorrën gjatë qeverisjes do të shtojmë përpjekjet dhe programet që e fuqizojnë pjesëmarrjen e mërgatës në vend.

Përmes "Dritares për Investime të Diasporës" do të mbështeten ndërmarrës nga diaspora deri në 100 milionë euro investime që bëhen në Kosovë.

Integrimi i Kosovës në SEPA do të krijojë lehtësi të mëdha për transferet e parave në Kosovë. Kështu do të eliminohen përfundimisht tarifat e larta dhe do të kursehen miliona euro të parave të diasporës tonë.

Mësimi i gjuhës shqipe me kurrikul të dedikuar për fëmijët e familjeve që jetojnë e punojnë jashtë vendit. Së bashku me Shqipërinë do të sigurohem që të mbahet mësimi i gjuhës shqipe në të gjitha shtetet ku ka komunitet të madh shqiptar.



FAMILJA

Ne kemi mbështetur familjet nga subvencion i rrymës tek shtesat e fëmijëve e për mandatin e ri po shtojmë një program të ri për gjyshërit e secilës familje që ka fëmijë.

Programi "Gjenerata për gjeneratë"

Në kuadër të mbështetjes për familjen, do të nisim skemën e mbështetjes së gjyshërve pensionistë që kujdesen për nipat dhe mbesat, në rastet kur të dy prindërit punojnë. Secila gjyshe apo secili gjysh pensionist, që përkujdeset për mbesa e nipa të moshës 13-36 muaj, kur prindërit punojnë, do të marrin edhe 100 euro shtesë për çdo muaj, mbi pensionin ekzistues.

Përveç rritjes së mirëqenies për pensionistët gjyshër, ky program synon ruajtjen dhe përforcimin e bërthamës së familjes duke sjellë më afër tri gjeneratat e një familjeje, dhe njëkohësisht mundëson që edhe gratë të integrohen në tregun e punës.



GRATË

Paralelisht masave që mbështesin vajzat në studime, gratë në biznes, nënënat me fëmijët, artistet dhe sportistet në mandatin e ri që në 6 muajt e parë do të startojmë me programin e ri për punësimin e grave.

Programi "Superpuna për gratë"

Programi Superpuna për Gratë do të garantojë pagën minimale për 6 muajt e parë, për secilën grua që dëshiron të rikthehet në tregun e punës. Pra, për bizneset bëhet e leverdishme të punësojnë gratë, sepse pagën e paguan shteti për 6 muajt e parë, kurse për gratë bëhet më e lehtë të gjejnë punë.

Ky model tashmë është dëshmuar i suksesshëm me të rinxjtë, dhe këtë po e zgjerojmë edhe për të gjitha gratë.



PUNËTORËT

Rritja e Pagës minimale

Pasi kemi rritur pagën minimale këtë mandat do të vijojmë me rritjen gjatë mandatit të ri. Gjatë mandatit të ardhshëm paga minimale do të rritet mbi 500 euro. Paga minimale nuk do të tatohet. Kjo nënkupton që dhe për biznesin e vogël individual, 6000 eurot e para të fitimit vjetor do të jenë të liruara nga tatimi.

Fondi i Sigurimeve Shoqërore

Do ta themelojmë Fondin e Sigurimeve Shoqërore përmes të cilit do të mbulohet pagesa për pushimin e lehonisë dhe prindëror dhe pagesa në rast të humbjes së vendit të punës.

Inspektorët e punës

Për këtë mandat të ri do ta rrisim sërisht numrin e inspektorëve deri në 200 inspektorë të punës.



STUDENTËT

Në vitin e parë ne hoqëm pagesën e studentëve duke e bërë falas shkollimin në Universitetet publike.

Programi i bursave "Mobiliteti për studentë"


Ne kemi një seri programesh të bursave të bazuara në merita dhe prioritete strategjike shtetërore që i kemi aplikuar gjatë mandatit që po përfundon.

Në mandatin e ri po shtojmë bursat e mobilitetit dhe mbështetjen për të gjithë studentët. Do të krijojmë pra, programin e ri "Mobiliteti për studentë" që mbështet të gjithë studentët në nevojë, të cilët kryejnë studimet në një lokacion tjeter nga ai ku jetojnë.

Studentët që kualifikohen për programin e bursës "Mobiliteti për studentë", për çdo muaj do të marrin një bursë, varësisht nga distanca që ka vendi ku studiojnë me vendin ku jetojnë.

Mbështetje për të gjithë studentët

Pasi rritëm mbështetjen për studentët në universitetet publike dhe për studentet vajza e gra në STEM, mbështetjen me bursa do ta zgjerojmë edhe për studentët që vijojnë studimet në shkollimin universitar jo-publik. Për këtë, do të dyfishojmë buxhetin e ndarë për bursa nga ai që kemi aktualisht.



SHKOLLIMI

Edukimi i fëmijëve

Do vazhdojmë mbështetjen me prioritet të lartë për edukimin e hershëm. Vendi ynë i ka 108 mijë fëmijë 1-5 vjeç. Sigurojmë që krahas rritjes së përfshirjes së tyre në çerdhet publike do të fillojmö edhe me sistemin e bonove për ata prindër që vendosin të dërgojnë fëmijtë e tyre në çerdhe jopublike.

Si dhe synojmë përfshirjen në ciklin parafillor të të gjithë fëmijëve nga mosha 5-6 vjeç ku janë rrëth 20 mijë fëmijë.

Mësimdhënia

Për të diplomuarit në fushën e pedagogjisë hyrja në profesion do të bëhet pas licencimit në nivel shtetëror të çdo të diplomuari në rast aplikimi për mësimdhënës në nivelin parauniversitar.

Ndërsa licensimi i avancuar i mësimdhënësve në nivelin sipëror do të shoqërohet me rritjen e pagesës së tyre.

Tekstet shkollore

Do të vijojmë dhe thellojmë procesin e rishikimit dhe rivlerësimit i të gjitha teksteve shkollore. Nga gjuha e matematika që i rishikuam tanimë do të vijohet me të gjitha tekstet e tjera për të gjithë arsimin parauniversitar. Si dhe për disa lëndë do të fillojmö me përkthimin dhe digitalizmin e materialeve shkollore.

Arsimi dual e profesional

Për Arsimin dual e profesional do të krijojmë platformën me profilet e secilit të diplomuar në arsimin profesional dhe arsimin dual për qasje në tregun e punës.

10 profile të reja do të shtohen në mësimin dual në përgjigje të kërkesave të industrisë duke ia bashkëngjitur 12 profileve aktuale.

Në arsimin profesional do të vijojë forcimi me investime në mjete mësimore, marrëveshje me industrinë dhe fushat ku përgatiten nxënësit.

Digjitalizmi i proceseve shkollore

Digjitalizimi i certifikatave dhe materialeve shkollore dhe finalizimi i një Platforme të centralizuar digitale për menaxhimin e shkollave, ditarëve dhe materialeve shkollore digitale janë hapat e radhës.

Klasat e mësimit do t'i pajisim me tabela të mençura. Do të shtrijmë internetin brezgjerë me shpejtësi të lartë edhe në institucione të arsimit parauniversitar së bashku me qasjen falas në internet.

Universitetet publike

Ne do të mbështesim gjithnjë e më shumë programet e kërkimit shkencor të universiteteve publike. Në mandatin e ri Universitetet publike do të profilizohen si dhe do të fillojë planifikimi për buxhetimin e bazuar në vlerësimin e performancës.

Në Qendrën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" do ta ndërtojmë një konvikt të ri dhe tre salla të reja për bibliotekë universitare brenda Qendrës së Studentëve.



SHËNDETI

Çdo qytetar i yni do të ketë mjekun familjar dhe do të jetë brenda Regjistratit të kujdesit parësor shëndetësor.

Sigurimet shëndetësore

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për sigurimet shëndetësore dhe kompletimit të sistemit informative shëndetësor hapet rruga drejt funksionalizimit përfundimtar të sistemit të sigurimeve shëndetësore.

Masat e reja

Në mandatin e ri do të decentralizojmë në tërësi shërbimet shëndetësore. Për këtë do të investojmë në çdo spital rajonal në pajisje, shërbime të reja dhe infrastrukturë. Do të ndërtojmë spitalin e ri në Mitrovicë dhe Ferizaj.

Poliklinikat specialistike do t'i ndërtojmë në Drenas, Sharr, Podujevë, Viti, Rahovec e Leposaviq.


Si dhe do të hapim Poliklinikat specialistike stomatologjike në Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj e Podujevë

Po ashtu do të ndërtojmë rrjetin e laboratorëve publik që mbulojnë të gjitha llojet e analizave me kosto të përballueshme.

Barnat

Lista e rimbursueshme e barnave fillon për herë të parë duke mbështetur qytetarët për shpenzimet lidhur me barnat jashtëspitalore.

Për Listën esenciale të barnave sigurojmë shtim të buxhetit deri në 100 milionë euro. Ndërsa kemi unifikuar çmimet e barnave në të gjithë territorin e vendit me çmime të përballueshme.



BUJQËSIA

Mandatin që po e përfundojmë fermerët e Kosovës i bëmë më të mbështeturit në rajon për këtë dëshmitarë i kemi mbi 120 mijë fermerë që përfituan mbi 300 milionë euro grante e subvencione. Më e rëndësishmja është që subvencionet kanë shkuar të gjitha tek fermerët dhe janë ndalur abuzimet e shpërdorimet që mbizotëronin në të kaluarën.

Në mandatin e ri përqëndrimi ynë do të jetë tek rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë përmes mbështetjes së investimeve në teknologji e rrjetëzim të mbledhjes dhe shpërndarjes së produkteve bujqësore.

E kemi subvencionuar akcizën e naftës, dhe tash do ta bëjmë edhe skemën e sigurimit nga fatkeqësitë natyrore për prodhimin bujqësor.



UJËRAT

Uji i pijes

Sa i takon furnizimit me Ujë të pijes do të përfundojmë projektimin dhe më pas ndërtimin e të gjithë rrjetit të ujësjellësit në të gjitha lokalitetet e banuara.

Siguria e furnizimit

Për të pasur sigurinë e furnizimit me ujë do të fillojë puna për 5 digat e reja në Kosovë.

Do të ndërtohen 5 rezervuarë për ujë të pijes, ujitje dhe industri dhe po përgatitemi për 4 të tjerë si studime fillestare.

Rezervuaret që do të ndërtohen janë Rezervuari i poshtëm i Firajës, Rezervuari i Pollatës, Rezervuari i Kuçicës, Rezervuari i Dragaçinës dhe ai i Desivojcës.



ENERGJIA DHE MINIERAT

Siguria e gjenerimit

Përballueshmëria e çmimeve, pavarësia energetike dhe ndikimi në shëndet janë parësore në politikën tonë energetike.

Prandaj, Kosova do të ketë një miks të energjisë që bazohet në burime vendore, dhe gjithnjë e më shumë në burime të pastra të ripërtëritshme nga era e dielli. Termocentrali "Kosova B" do të modernizohet, ndërsa Termocentrali "Kosova A" do të rehabilitohet thellësisht ashtu që të rritet siguria e furnizimit, dhe të ulet ndjeshmëria ndaj krizave eventuale nga jashtë.

Do të intensifikojmë bashkëpunimin për ndërtimin e kapaciteteve të përbashkëta me Shqipërinë.

Ne do të sigurohemi po ashtu që Kosova të jetë në ballë të zhvillimeve teknologjike në energji, duke shtuar në mësinë energjetikë burime jo-tradicionale me teknologji inovative nga partnerët strategjikë.

Ngrohja

Do të ndërtojmë sisteme të reja të ngrohjes qendrore edhe në Ferizaj dhe Gjilan. Ndërsa do të dyfishojmë kapacitetin e mbulueshmërinë e ngrohjes qendrore në Prishtinë.

Efiçienca

Do të vazhdojmë investimet në efiçencë të energjisë, me vlerë 150 milionë euro për familjet që kanë nevojë për përkrahje për të izoluar shtëpitë e tyre, e për të siguruar kushte më të mira për nxënësit, pacientët, sportistët e zyrtarët në ndërtesa publike si shkolla, spitale, salla sporti, etj. Kështu, sigurojmë kushte jetese më të mirë për qytetarët, ngrohje me çmime të përballueshme e lehtësim të ngarkesës në rrjetin elektroenergjetik.

Minierat

Sektori minerar është sektor strategjik me rëndësi për ekonominë e për sigurinë kombëtare, Prandaj, do të themelojmë partneritet strategjik në nivel të shtetit për hulumtimet e investimet e përbashkëta në këtë sektor. Trepça do të jetë në qendër të sektorit, ndërkohë që hulumtimet e investimet do të zgjerohen në zonat e tjera me potencial të lartë.



INFRASTRUKTURA

Hekurudhat

Në mandatin e ri do të fillojmë me ndërtimin e hekurudhës Prishtinë – Durrës, që përmban segmentin Gjakovë – Shkodër, dhe do të projektojmë linjën hekurudhore që lidh Prizrenin e Ferizajin me Gjilanin dhe Bujanocin.

Rrugët

Do të përfundojmë ndërtimin e rrugës Prizren-Tetovë, autostradën Prishtinë – Gjilan me vazhdim deri tek Dheu i Bardhë dhe Autostradën Duhle-Shtime-Banullë. Po ashtu do të ndërtojmë rrugën e Dukagjinit që lidh Prizrenin, Rahovecin, Gjakovën, Deçanin me Pejën e Istogun. E do të vazhdojmë me ndërtimin e rrugëve Decan - Plavë dhe Pejë – Rozhajë.

Ruga Dollc – Gjakovë, Kijevë – Zahaq do të finalizohen krahas rehabilitimit dhe modernizimit të të gjitha rrugëve rajonale.

Porti i thatë

Ndërtimi i Portit të thatë i cili e vendos Kosovën në hartën ballkanike të transportit të mallrave është një nga projektet madhore që do ta finalizojmë.




PROJEKTET KAPITALE

Dy vitet e fundit të mandatit kemi shënuar rekorde në ekzekutimin e investimeve kapitale dhe këtë ritëm do ta përshpejtojmë edhe më tutje duke reformuar sistemin e prokurimit publik.

Kjo do të mbërrihet duke siguruar procese eficiente dhe që sjellin vlerë për para, ashtu që ekzekutimi i investimeve kapitale të tejkalojë 1 miliardë euro në vit.

Hapi pasues pas krijimit të sistemit për gjurmim të faturave që siguron se çdo faturë paguhet në kohë ndaj operatorit ekonomik, do të kompletajojmë edhe integrimin e sistemit të menaxhimit të financave publike me sistemin e e-prokurorimit. Kështu sigurojmë disiplinën fiskale që parandalon futjen e organizatave buxhetore në detyrime financiare pa mbulesë.



KOMUNAT

Me finalizimin e regjistrimit të popullsisë do të transformohet dhe buxhetimi për Komunat.

Skema e granteve do të përshtatet sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë dhe Granti i katërt po ashtu do të zbatohet bashkëngjitur skemës së re të ndryshuar të buxhetimit të secilës Komunë.

Buxhetimi i bazuar në të dhënat mbi popullsinë do të transformojë në mënyrë të pakthyeshme kushtet dhe kapacitetet për ofrimin e edukimit, të shërbimeve shëndetësore, investimeve në infrastrukturë urbane e rurale dhe në atë të ujësjellësve dhe kanalizimeve.

Krahas paketës së ligjeve për financat e nivelit lokal, do të rishikojmë edhe ligjin për tatimin në pronë për të kompletuar kështu tërësinë e ligjeve që sigurojnë burimet financiare për komunat.




SPORTI

Lojërat Mesdhetare 2030 janë shtylla kyçë e transformimit të Kosovës në epiqendër sportive në rajon dhe më gjjerë. Pallati i Rinisë dhe Sporteve dhe Qendra e Studentëve në Prishtinë do të kthehen në hapësira moderne mikpritjeje, duke vazhduar t'u shërbejnë qytetarëve për dekada.

Plani për infrastrukturën e futbollit, duke përfshirë Stadiumin Nacional, Qendrën Akuatike me pishina olimpike, si dhe pishinat gjysmë-olimpike do tëjenë themel i zhvillimit dhe cilësisë, ndërsa palestrat ekzistuese do të modernizohen sipas standardeve ndërkombëtare.

Nëpërmjet programit "Sport në Shkolla" do të ndërthurim sportin me arsimin dhe shëndetin, duke nxitur një shoqëri aktive dhe të shëndetshme.

Do të vazhdojmë të forcojmë qeverisjen sportive përmes transparencës dhe llogaridhënieς, për një sistem të qëndrueshëm dhe të drejtë.



ARTI

Arti dhe kultura do të jetë e vendosur në zemër të planifikimit shtetëror. Politika e ekonomisë kreative do të jetë synim në katër vitet e ardhshme.

Për krijuesit e performuesit vijojmë me mbështetjen e artistëve të pavarur dhe ansambleve rezidente nëpërmjet sigurisë financiare, autonomisë krijuese dhe sigurimit të hapësirave të dinjitetshme për punë. Do të ndërlidhim krijimtarinë artistike me tregun e punës dhe sigurohem që prodhimet kulturore të kenë kompensimin e duhur.

Me vazhdimin e programit "Arti në Shkolla" në të gjithë vendin do të vazhdojë edukimi i audiencës, identifikimi i talenteve artistikë dhe integrimit të kulturës në përditshmërinë shoqërore. Secili fëmijë do të ketë qasje në aktivitet kulturor.

Edhe në mandatin e dytë do të vazhdojmë të modernizojmë objektet kulturore, duke i transformuar në qendra bashkëkohore të krijimtarisë dhe ndërveprimit.

Projekte të mëdha si Teatri i Operës dhe Baletit dhe Muzeu i Artit Bashkëkohor do të bëhen pika referimi globale, duke ofruar hapësira të denja për krijimtari e bashkëpunime ndërkombëtare.



TRASHËGIMIA KULTURORE

Mandati i parë ishte i shpëtimit të monumenteve. Në mandatin e ri për trashëgiminë kulturore, nga mbrojtja fizike kalojmë në funksionalizim. Monumentet do t'i vëmë në shërbim të komunitetit dhe ekonomisë. Krahas ruajtjes së historisë e fuqizimit të identitetit, trashëgiminë do ta kthejmë në kontribuues për mirëqenien e shoqërisë.

Arkeologjia do të mbetet prioritet i lartë përmes investimeve në gërmim, studim e menaxhim, ndërsa zonat arkeologjike do të vazhdojmë t'i bëjmë prona shtetërore. Qendrat historike të Kosovës do të rijetësohen në shërbim të turizmit, në bashkërendim me banorët dhe bizneset e këtyre zonave.

Programi për muzetë i nisur në mandatin e parë do të zgjerohet në shumë komuna, me funksionalizim të muzeve ekzistues e themelim të muzeve të ri. Krahas hartimit të master-planit, do të kujdesemi për nisjen e punëve konservuese në Prekaz, në Kullat e Rezistencës brenda Kompleksit Memorial "Adem Jashari"si vendi me shenjën më sublime të luftës çlirimtare dhe Komendantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Trashëgimia shpirtërore do të ketë trajtim të veçantë përmes dokumentimit dhe promovimit. Politika e konservimit të integruar do të jetë udhërrëfyes edhe i mandatit të dytë, me trashëgiminë pjesë integrale të planeve hapësinore dhe zhvillimore.



DREJTËSIA

Gjykata për çështje familjare

Çështjet si prona, trashëgimia, dhuna në familje, divorcet e alimentacioni nuk mund të presin dekadën për t'u zgjidhur. Problemet familjare duhen zgjidhur shpejt dhe me efikasitet. Përgjigja jonë do të jetë themelimi i Gjykatës për çështje familjare e cila me prioritet e shpejtësi do t'i trajtojë rastet që qytetarët i adresojnë në Gjykata.

Prokuroria e Specializuar për luftimin e krimit të organizuar dhe korruptionit

Do të themelojmë Prokurorinë e re të specializuar për çështjet e krimit të organizuar dhe korruptionit me përkrahje dhe model të vendeve që e kanë e kryer me sukses këtë betejë në Evropë.

Nuk ka asgjë më të rëndësishme për drejtësinë sesa që institucioni i hetimit të jetë në nivelin e detyrës në raport me rrjetet kriminale që janë në vijimësi të organizuar kundër shtetit dhe të drejtës në tërësi.

Themelimi i Zyrës për Hetime Disiplinore

Zyra për hetime disiplinore do të jetë një strukturë e re që garanton balancë dhe kontroll të efektshëm ndërmjet pushteteve, duke rritur llogaridhëni e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit prokurorial të Kosovës për veprimet e tyre.

Zyra do të jetë përgjegjëse për trajtimin e ankesave dhe pretendimeve për sjellje të papërshtatshme nga gjyqtarët dhe prokurorët. Procesi disiplinor do të mund të iniciohet edhe ex officio. Zyra do të kryejë mbledhjen e provave dhe paraqitjen e çështjeve përpara Komisioneve Disiplinore të KGJK dhe KPK.



SIGURIA

Gjatë mandatit të ri do të vijojmë punën për rend dhe ligj në të gjithë vendin cep më cep. Krahas luftës kundër krimít të organizuar do të shtohen kapacitetet dhe programet për sigurinë publike. Siguria rrugore, ajo në shkolla dhe policimi në komunitet janë prioritet i mandatit të ri.

Do të vijojmë me mbështetjen e Policisë dhe institucioneve të sigurisë me pajisje të specializuara e bashkëkohore, me shkollim e trajnim si dhe me armatim adekuat.

Do të avancojmë Njësinë e Dronëve dhe Antidronëve për të forcuar mbikëqyrjen dhe gatishmërinë për t'u përballur me format e reja të rreziqeve të sigurisë, duke ndihmuar në hetime, mbrojtje dhe mbikëqyrje të kufirit si dhe rritjen e sigurisë publike në përgjithësi.

Vendi do të ketë kufij të sigurtë dhe të menaxhuar me teknologjité më të avancuara. Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit do të modernizohet për të garantuar sigurinë, lehtësuar qarkullimin e mallrave dhe njerëzve dhe parandaluar aktivitetet kriminale.



MBROJTJA

Për ushtrinë tonë në katër vitet e ardhshme do të ndajmë buxhet mbi 1 miliardë euro.

Do të thellojmë dhe zgjerojmë bashkëpunimin ndërkombëtar bilateral dhe multilateral me shtetet anëtare të NATO-s.

Funksionalizimi i Fabrikës së Municioneve dhe zhvillimi i industrisë ushtarake i Kosovës.

Gjatë mandatit të ri do të zhvillojmë dronët ushtarakë "Made in Kosova".

Fuqizimi i ushtrisë do të realizohet përmes blerjeve të armatimit, stërvitjes dhe edukimit brenda vendit, në bashkëpunim me Shqipërinë dhe në akademitë më të shquara ushtarake në vendet partnere.

Do ta krijojmë Njësinë ushtarake të përbashkët me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Rekrutimi i kadetëve të rinj do të vijojë me ritëm të shtuar. Synojmë që brenda mandatit të ri do të kemi 1000 gra e vajza ushtarake.

Programi i Mbrojtjes Gjithëpërfshirëse do të zbatohet në të gjithë vendin. Në kuadër të këtij programit secili rezervist vullnetar do ta ketë trajnimin adekuat si dhe armatimin në rast mobilizimi.



POLITIKA E JASHTME DHE INTEGRIMET EVROPIANE

Politika e jashtme

Do të forcojmë edhe më tej marrëdhëniet strategjike të vendit me partnerët.

Fuqizimi i mëtutjeshëm i pasaportës së Republikës së Kosovës në të gjitha kontinentet është një nga synimet tona krahas arritjes së marrëveshjeve dypalëshe për lirimin nga regjimi i vizave. Ky zhvillim do të krijojë mundësi të reja ekonomike, tregtare, kulturore dhe arsimore për qytetarët e vendit.

Marrja e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian do të jetë një nga angazhimet kyçë tonat.

Dyfishimi i rrjetit të atasheve të mbrojtjes dhe shtimi i shteteve partnere me të cilat nënshkruajmë marrëveshje SOFA janë hapat që do t'i ndërmarrim në vijim drejt anëtarësimit të plotë në NATO.

Zgjerojmë dhe thellojmë marrëdhëniet dypalëshe me shtetet mosnjohëse, me theks të veçantë me shtetet mosnjohëse të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës;

Synojmë drejtimin e së paku një nisme rajonale dhe organizimin e konferencave dhe samiteve të rëndësishme rajonale në kuadër të integrimit të gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Shërbimit Diplomatik dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për luftimin e dezinformimit që gjenerohet dhe shërndahet nga aksi i vendeve autoritare në rajonin tonë, Evropë dhe në kontinentet e tjera.

Do ta hapim edhe më tej Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik për kuadrot e reja të vendit dhe mërgatës tonë.

Do ta vendosim rrjetin e atasheve ekonomik dhe tregtar si mekanizëm për identifikimin dhe tërheqjen e investimeve të jashtme dhe gjetjen e tregjeve të reja për eksport të prodhimeve vendore.

Njëjtë do të veprojmë edhe me rrjetin e atasheve kulturor për promovimin e artit dhe kulturës së vendit, duke krijuar mundësi të reja për artistët dhe studentët e artit.

Integrimi në Bashkimin Evropian

Si demokracia më e avancuar në rajon me rritje të vazhdueshme ekonomike, plotësisht e harmonizuar me politikën e jashtme të BE-së dhe bartëse e vlerave të BE-së, vizioni ynë është ta përgatisim vendin për t'i bërë ballë presionit konkurrues të tregut rajonal e atij evropian dhe të ecim përpara në proceset integruese euro-atlantike.

Me 15 dhjetor 2022, zyrtarisht dorëzuam aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian me synim marrjen e statusit kandidat. Synimi ynë është që deri në vitin 2030, vendi ynë të ketë përmbyllur me sukses të gjithë kapitujt nga procesi i integrimit, drejt anëtarësimit në BE.

Ne do të sigurohemi që shteti ynë të jetë pjesëmarrës aktiv dhe i barabartë në të gjitha nismat rajonale dhe do të angazhohemi për integrimin ekonomik të plotë në Tregun e Përbashkët Rajonal e për zbatimin e të gjitha obligimeve që dalin nga procesi i Berlinit. Kosova është dhe do jetë plotësisht e harmonizuar me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian edhe në mandatin tonë të ri.

Plani i rritjes i BE-së paraqet një mundësi të mirë për përshtypjen e reformave për integrim evropian. Agjenda e Reformave për vitet 2025-2028 do të jetë prioritet i yni për të përfituar sa më shumë fonde nga BE dhe përafrim me Tregun e Brendshëm BE-së.



Albin Kurti ✓

cep

möcep

cep më cep
✓ | 118

